REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr.011/01-2740 /2021
Dt. 28.01.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 Nr.011-10 të datës 26.12.2008, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2021, pas diskutimeve lidhur më pikën e 12-të të rendit të ditës: Kërkesë për Pezullimin e Taksës për çertifikimin e punës me pije Alkoolike për vitin 2021, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesë për Pezullimin e Taksës për çertifikimin e punës me pije Alkoolike për vitin 2021 në Komunën e Gjakovës .

2. Pezullohet taksa për çertifikimin e punës me pijet alkoolike për vitin 2021 e cila është e përcaktua me rregulloren 01.Nr.011-43963 e datës 06.07.2015 .

3. Qëllimi i këtij pezullimi është ndihmesa për sektorin e gastronomisë në tejkalimin e pasojave të shkaktuar nga Pandemia Covid 19 .

4. Pezullim i taksës së përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi vlen vetëm për vitin 2021 .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

6. Vendimi iu dërgohet:
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa .
- Drejtorisë për Punë Inspektuese .
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit .

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

z. Anton Shala